

Vlora (Musa) Zogaj

(11.07.1982, shqiptare nga Mleqani/Mleçane, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënëse)

Vlora ka qenë nxënëse e klasës së parë të shkollës së mesme *Beqir Gashi* në Malishevë/Mališevo. Jetonte me familjen e vet në **Mleqan/Mleçane**. UÇK-ja i mbante pozicionet në këtë fshat. Policia serbe gjendej e pozicionuar në fshatin fqinj të Kijevës/Kijevo. Në mbrëmje të datës **18.07.1998**, forcat serbe e filluan bombardimin e Mleqanit/Mleçane. Vlora rastisi të ishte në oborr, së bashku me të ëmën Zarifen. Ia dha vrapit drejt garazhit, ku gjendeshin motra e saj Shote, gjyshja Nazife dhe halla Hajrije. Pas pak, dy predha kanë rënë mbi garazhin, duke e plagosur rëndë Vloren dhe Hajrijen. Vlorën e kishin qëlluar në stomak, ndërkaq Hajrijen në kokë. Komshinjtë e çuan Vlorën, Hajrijen dhe një fqinje të tyre, e cila po ashtu ishte e plagosur, në ambulancën e UÇK-së në Malishevë/Mališevo, nga ky i bartën në spitalin e UÇK-së në Gajrak. Në dalje të qytetit, Vlora ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse. I ati Musa me ndihmën e komshinjve e kanë varrosur Vlorën në orët e vona të mbrëmjes, më 19.07.1998, në varrezat familjare në Mleqan/Mleçane.

Burimet: deklarata Z.Z, FDH-16613; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.

Nebih (Sadik) Thaqi

(20.02.1928, shqiptar nga Shkarashniku/Skorošnik, komuna e Malishevës/Mališevo, nëntë fëmijë)

Nebih Thaqi jetonte me bashkëshorten Zelfijen, djalin Sadikun dhe familjen e tij në **Shkarashnik/Skorošnik**. Për shkak të sulmit të forcave serbe më **23.07.1998**, familjarët e Nebihut u strehuan në fshatin fqinj të Tërpezës/Trpeza [Malishevë/Mališevo], ndërkaq ai vazhdoi të qëndronte në shtëpi. Të nesërmen, nga Tërpeza/Trpeza mund të shihej se forcat serbe kishin hyrë në Shkarashnik/Skorošnik dhe u vënin zjarrin shtëpive të vendasve. Familjarët e Nebihut kanë mësuar nga disa banorë të Vërmicës/Vrmnica, se më 1.08.1998, e kishin vërejtur trupin e një burri në vendin e quajtur *Kroni*

i Çobanit/Çobanov izvor, në Carallukë/Crni Lug, pranë së cilës qëndronte një qen. Familjarët menjëherë kuptuan se bëhej fjalë për Nebihun, sepse qeni i tij kurrë nuk ndahej nga ai. Në datën 21.08.1998, Sadiku me kushëririn Lulzim Thaqin arritën që t'i afroreshin fshatit dhe ta merrnin trupin e Nebihut. Po atë ditë, atë e kanë varrosur në Shkarashnik/Skorošnik.

Burimet: deklarata Z.T, FDH-17604; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857.

Milaim (Avdullah) Berisha

(22.03.1975, shqiptar nga Zajmova/Zajmovo, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtime)

Në fund të muajit maj të vitit 1998, forcat serbe kishin depërtuar në Zajmovë/Zajmovo dhe gjuanin me armë zjarri nga hoteli *Nora*. Milaimi me prindërit, vëllezërit dhe motrat u larguan nga fshati. Shkuan së pari në Klinë/Klina, pastaj në Pejë/Peć, ku i ka strehuar Ukë Çufaj. Nga mesi i muajit qershor, ata kanë kaluar në **Llashkadrenoc/Vlaški Drenovac**. Përmes kushëririt Hamdiut [të shikohet regjistrimi], Milaimi nisi ta ndihmonte UÇK-në – me makinën e vet i transportonte ushtarët, të cilët i bartnin armatime nga Shqipëria. Në datën **24.07.1998**, Milaimi me një person të paidentifikuar u nisën për në Shqipëri. Nënës Hales i tha se do të kthehej për disa javë. Nga ajo ditë, atij i humbet çdo gjurmë. Familjarët nuk kanë kurrfarë njohuri për fatin e Milaimit as sot. Në listën e të zhdukurve e KNKK-së, rasti i Milaimit është regjistruar në dosjen me numër BLG-802122-01.

Burimet: deklarata A.B, FDH-17172; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31239; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

Doruntina (Isuf) Krasniqi

(10.06.1997, shqiptare nga Llashkadrenoci/Vlaški Drenovac, komuna e Malishevës/Mališevo)

Doruntina ishte vajza e vogël e Isufit dhe Rifadije Krasniqit. Isufi ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Rifadija me vajzat ka shkuar më 20.07.1998 për një vizitë te prindërit e saj në